



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe bazuar në nenin 37 të Ligjit Nr. 06L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, merr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Erëza Havolli, Zyrtare e Lartë Ligjore në Departamentin Ligjor caktohet zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtares për mbrojtjen e të dhënave janë:
 - 2.1. informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin si dhe të punësuarit, që kryejnë përpunimin e të dhënave lidhur me detyrimet e tyre në përputhje me Ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale;
 - 2.2. jep këshilla sipas nevojës lidhur me vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron zbatimin në përputhje me legjislacionin përkatës; dhe
 - 2.3. bashkëpunon si dhe shërben si pikë kontakti për Agjencinë për Informim dhe Privatësi për çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave, përfshirë konsultimet paraprake, si dhe ofron këshillim për çështje të tjera në pajtim me legjislacion në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet vendimi Nr. 3169 i datës 03.10.2023.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 17.04.2026

Leonita Shabani Mullarama

Sekretare e Përgjithshme



Vendimi i dërgohet:

- Znj. Erëza Havolli;
- Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
- Arkivit.

REPublika e Kosovës / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISË MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit	02	Nr. Prof. Br. Prof.	701
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	1	Prof.No: Datum: Date:	21.04.26
PRISHTINË/A		NO.1	